



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

## GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:105534  
Datë: 12.03.2024  
Numri i dokumentit: 05436628

**CAP.nr.15/2024**

**GJYKATA E APELIT TË KOSOVËS NË PRISHTINË**, Kryetari i Gjykatës Valon Totaj, me bashkëpunëtoren profesionale Blerina Sallauka, në çështjen përmbare të kreditorit G.K. nga P..., të cilin e përfaqëson i autorizuari i tij av.S.K. nga P..., kundër debitorit Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës - (SHSKUK), me seli në Prishtinë, për shkak të borxhit në emër të shpërblimit jubilar, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë Cpc.nr.528/2023, të datës 10.11.2023, me datën 08.03.2024, mori këtë:

### **A K T V E N D I M**

**REFUZOHET si e pabazuar** ankesa e debitorit Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës - (SHSKUK), me seli në Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë Cpc.nr.528/2023, i datës 10.11.2023, **VËRTETOHET**.

### **A r s y e t i m**

Gjykata Themelore në Prishtinë, me aktvendimin Cpc.nr.528/2023, të datës 10.11.2023, në pikën I të dispozitivit e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës - (SHSKUK), me seli në Prishtinë, i ushtruar kundër Aktvendimit Cpc.nr.528/23, të datës 12.10.2023, ndërsa në pikën II e ka obliguar debitorin t'ia paguaj kreditorit shumën prej 156.00 euro në emër të përpilimit të përgjigjes në prapësim

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor debitori ka paraqitur ankesë dhe atë për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës përmbare, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë

të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta aprovoj ankesën e debitorit si të bazuar dhe aktvendimin e atakuar ta anulojë si të pabazë, të pasafatshëm dhe i palejueshëm pasi që kemi të bëjmë me res judicata.

Përgjigje në ankesë ka parashtruar i autorizuari i kreditorit me propozim bërë Gjykatës së Apelit që ankesën e debitorit ta refuzojë si të pabazuar ndërsa aktvendimin e ankimuar ta vërtetojë.

Gjykata e Apelit e Kosovës, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 lidhur me 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore (LPP), gjeti se:

- ankesa e debitorit, është **e pabazuar**.

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori G.K. me datën 05.05.2023, ka paraqitur propozim për përmbartim, ndaj debitorit Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës - (SHSKUK) e Kosovës, me seli në Prishtinë, në bazë të Vendimit të Inspektoratit të Punës në Prishtinë 01 Nr.21-1715/94 të datës 10.02.2020, Vendimit nr.303/2020 të datës 19.05.2020 dhe Vendimit për korrigjimin e gabimeve Nr.01/21-1178 të datës 18.11.2020. Gjykata Themelore në Prishtinë me datën 12.10.2023, ka nxjerrë aktvendimin Cpc.nr.528/23, me të cilin ka caktuar përmbartimin. Kundër aktvendimit për caktimin e përmbartimit, debitori me datën 20.10.2023, ka paraqitur prapësim me të cilin ka kërkuar që të aprovohet prapësimi i debitorit, duke propozuar që i njëjti të aktvendimi i atakuar të anulohet si i pa bazë, i pasafatshëm dhe i palejuar. Kreditori me datë 01.11.2023, ka parashtruar përgjigje në prapësim.

Duke vendosur mbi prapësimin e debitorit, gjykata e shkallës së parë ka nxjerr aktvendimin e ankimuar Cpc.nr.528/2023, të datës 10.11.2023, me të cilën e ka refuzuar si të pa bazuar prapësimin e debitorit dhe ka vendosur sikurse në dispozitiv të të njëjtit. Në arsyetim të aktvendimit të ankimuar, gjykata ka theksuar se pas shqyrtimit të prapësimin të debitorit, si dhe shikimit dhe vlerësimit të shkresave tjera të lëndës, ka gjetur se debitori i përmbartimit nuk ka ofruar prova në mbështetje të pretendimeve të tij siç është paraparë me nenin 69 par. 4 të LPP-së, rrjedhimisht nuk janë përmbushur asnjë nga kushtet ligjore për anulimin e aktvendimit mbi caktimin e përmbartimit, apo shtyrjen e zbatimit të përmbartimit, të përcaktuara me dispozitat e nenit 61 par 1 pika 1 dhe nenit 71 par 1, pika 1 deri në 12 të LPP-së. Në këtë rast mund të lejohet përmbartimi edhe në rastet kur vendimi i dhënë në procedurë administrative nuk është bërë përfundimtar, vetëm po që se me ligj është paraparë se ankesa apo mjetet e tjera juridike nuk e ndalojnë përmbartimin, me çka në rastin konkret ankesa e ushtruar në procedurën administrative ndaj vendimit të nxjerrë në atë procedurë nuk ka pasur efekt suspensiv, gjegjësisht nuk e ka shtyrë ekzekutimin e vendimit, ashtu që i njëjti është bërë i ekzekutueshëm nga dita e nxjerrjes së tij. Tutje ka theksuar se pretendimet e debitorit të përmbartimit se propozimi për përmbartim i kreditori është i pasafatshëm, gjykata vërejtë se dokumenti përmbartues në bazë të cilit është caktuar përmbartimi është nxjerrë në kohën sa ka qenë në fuqi Kontrata Kolektive Sektoriale. Ndërsa pretendimi se në këtë rast kemi të bëjmë me çështje të gjykuar (res iudicata), dhe se me

të njëjtin vendim gjykata e ka aprovuar prapësimin dhe e ka shfuqizuar urdhërin për përmbarrim, një pretendim i tillë për gjykatën është i pa bazuar ngase propozimi për përmbarrim është bërë në bazë të Vendimit të Inspektoratit të Punës për korigjimin e gabimeve Nr.01/21-1178 të datës 18.11.2020, i cili përcakton saktë shumën të cilën debitori obligohet t'ia paguaj kreditorit, rrjedhimisht me këtë dokument përmbarrues është bërë vetën në këtë rast propozimi për përmbarrim, dhe nuk kemi të bëjmë me çështje të gjykuar. Për mënyrën e vendosjes e njëjta i është referuar dispozitës së nenit 22, 24, 71 dhe 73 të LPP.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë, duke vlerësuar provat të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës të ofruar nga palët ndërgjyqëse, ka vendosur drejtë kur prapësimin e debitorit e ka refuzuar si të pabazuar duke dhënë arsye përkatëse në pjesën arsyetuese të aktvendimit të ankimuar. Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë, ka dhënë aktvendimin e saj të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon në tërësi edhe Gjykata e Apelit, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë as në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (b), (g), (j) (k) dhe (m) të LPK dhe se drejtë është zbatuar e drejta materiale, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK.

Gjykata e shkallës së parë drejtë ka konstatuar faktin se Vendimi i Inspektoratit të Punës në Prishtinë 01 Nr.21-1715/94 të datës 11.02.2020 dhe Vendimi për korigjimin e gabimeve Nr.01/21-1178 të datës 18.11.2020, në rastin konkret është dokument përmbarrues, kjo parashihet në nenin 22 paragrafi 1 pika 1.2 të LPP, e cila dispozitë përcakton se *“dokument përmbarrues është edhe vendimi përmbarrues i dhënë në procedurën administrative”* dhe përbën bazën juridike për caktimin e përmbarrimit sipas nenit 21 dhe 27 paragrafi 1 të po këtij ligji ku përcaktohet se *“dokumenti përmbarrimor është i përshtatshëm për përmbarrim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*, andaj pretendimet ankimore të debitorit se gjykata ka bërë shkelje të dispozitave të LPP me rastin e refuzimit prapësimi, nuk qëndrojnë.

Në procedurën përmbarrimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbarrimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbarrues që sipas propozimit të kreditorit të caktojë dhe zbatojë përmbarrimin. Nuk qëndrojnë pretendimet e debitorit se nuk e ka pranuar vendimin administrativ dhe ende pa përfunduar procedura e ankimit, kreditori ka parashtruar propozim për përmbarrim, për faktin se sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, gjykata në procedurë përmbarrimore i përmbahet parimit të rigorozitet formal juridik, nga i cili parim rrjedh se gjykata e vlerëson përshtatshmërinë e dokumentit përmbarrimor, vlerëson nëse janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e urdhrin për lejimin e përmbarrimit dhe në procedurën sipas prapësimi gjykata e shkallës i vlerëson shkaqet e treguara në prapësim nga neni 71 i LPP.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit pretendimet e debitorit të përmbarrimit se propozimi për përmbarrim i kreditori është i pasafatshëm, vërejtja se dokumenti përmbarrues në bazë të cilit

është caktuar përbarimi është nxjerrë në kohën sa ka qenë në fuqi Kontrata Kolektive Sektoriale, ndërsa sa i përket pretendimit se kemi të bëjmë me çështje të gjykuar vlerësoi se në rastin konkret propozimi për përbarim është bërë në bazë të Vendimit të Inspektoratit të Punës për korrigjimin e gabimeve Nr.01/21-1178 të datës 18.11.2020, rrjedhimisht me këtë dokument përbarues është bërë vetën në këtë rast propozimi për përbarim, andaj pretendimet e tilla u refuzuan si të pabazuara.

Tutje nuk qëndrojnë as pretendimet e debitorit lidhur me atë se vendimi i Inspektoratit të Punës nuk paraqet titull ekzekutiv, për faktin se sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit me dispozitën e nenit 24 paragrafi 5 të LPP përcaktohet se: *“Përbarimi caktohet në bazë të vendimit gjyqësor që ende nuk është bërë i formës së prerë, ose në bazë të vendimit të dhënë në procedurën administrative që nuk është bërë përfundimtar, vetëm po që se me ligj është paraparë se ankesa apo mjetet tjera juridike, nuk e ndalojnë përbarimin”*, ndërsa me Ligjin për Inspektoratin e Punës në Kosovë nr. 2002/9, konkretisht në nenin 6 paragrafi 4 është përcaktuar se: *“Ankesa e ushtruar në vendimin e Inspektorit të punës nuk e shtyn ekzekutimin e vendimit”*, ndërsa me dispozitën e nenit 144 paragrafi 1 pika 1.3 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative nr. 05/L-031, përcaktohet se: *“Një akt administrativ do të bëhet i ekzekutueshëm me:...njofitim e palës me aktin, kur, sipas ligjit, ankesa nuk ka efekt pezullues”*. Në kuptim të këtyre dispozitave, Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka vendosur në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme kur e ka refuzuar prapësimin e debitorit, sepse në rastin konkret ankesa e ushtruar në procedurë administrative ndaj vendimit të nxjerrë në atë procedurë nuk ka pasur efekt suspenziv gjegjësisht nuk ka shtyrë ekzekutimin e vendimit ashtu që i njëjti është bërë i ekzekutueshëm nga dita e nxjerrjes së tij, andaj edhe në këtë drejtim mbi bazën e këtij vendimi mund të lejohet përbarimi, pasi që ankesa e paraqitur nuk e ka ndaluar ekzekutimin.

Kompetenca e Gjykatës së Apelit për të vendosur nga ana e gjyqtari individual në shkallë të dytë bazohet në dispozitën e nenit 3 par.2 të LPP, me të cilën është paraparë se *“në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual”*.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP, lidhur me nenin 208 dhe 209, pika b), të LPK.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
**CAP.nr.15/2024, me datën 08.03.2024**

**Kryetari i Gjykatës**  
**Valon Totaj**